

Informacion Mujor – Gusht 2024

Emri i Fondit	Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur SIGAL Pro	Fondi i Pensionit Privat SIGAL Pro	Komision në Hyrje
Struktura Ligjore	Fond Pensioni*	Fond Pensioni*	Komision në Dalje
	Licencuar nga AMF me vendim nr. 251, datë 20.12.2022	Licencuar nga AMF me vendim nr. 251, datë 20.12.2022	Komision Vjetor Administrimi
Administrimi i Fondit	SIGAL UNIQA INVEST- Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive Sh.a.	Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive "SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA" Sh.a.	Penalitet për tërheqje të parakohshme
Themeluar	Janar 2006	Janar 2006	Komision Performance
Monedha	Lekë	Lekë	Shuma fillestare e kuotës
Banka Depozitare	Banka Kombëtare Tregtare	Banka Kombëtare Tregtare	Kontributi fillestar minimal
Auditues	Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k.	Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k.	Kontributi minimal pasues

*Rregulluar nga Ligji nr. 76/2023, "Për fondet e pensionit Privat"

Objektivat dhe Politika e Investimit

Objektivat e Investimit

Fondi i Pensionit ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit.

Politika e Investimit

Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Instrumentat në përbërjen e portofolit janë: (i) tituj të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me maturitete të ndryshme, (ii) mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe (iii) Depozita me afat në banka të nivelit të dytë të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Gusht 2024

Vlera Neto e Aseteve	4,474,248.63Lekë
Numri i anëtarëve	109
Çmimi i Kuotës	1,010.8494 Lekë
*Fitimi(01/01/2024-31/08/2024)	1.45%

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

**Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.




Figura 1-Përbërja e portofolit sipas kategorive





Figura 2-Përbërja e portofolit sipas maturitetit të mbetur


Performanca e Fondit deri në 31.08.2024

Gjatë muajit Gusht 2024 çmimi i kuotës dhe Vlera Neto e Aseteve të Fondit kanë patur një trend rritës krahasuar me muajin paraardhës.. Norma e rritjes të çmimit të kuotës për 8-të mujorin 2024 ka rezultuar 1.23%.

Rekomandohet që anëtarët të qëndrojnë sa më gjatë në fond në mënyrë që të përfitojnë maksimalisht nga kthimi i investimit.



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit të Fondit tregon luhatshmërinë historike të çmimit të kuotës.


Për Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur **SIGAL Pro**, treguesi është në nivelin 1, ose nivelin më të ulët i rrezikut.

Fondi ndodhet në këtë kategori pasi portofoli i investimeve është në pjesën kryesore të tij në Tituj të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

Kategoria e rrezikut mund të ndryshojë në të ardhmen.

*** Të dhënat e mësipërme janë të ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbëjnë garanci për të ardhmen.

Ecuria e Tregut të Titujve të Qeverisë Shqiptare



Tregu i Titujve të Qeverisë Shqiptare është karakterizuar nga një rënie e rendimentit për titujt për të cilët janë organizuar ankande gjatë këtij muaji. Raporti mesatar i mbulimit në ankandet e këtij muaji ka rezultuar 1.27, një rritje nga 1.11 raport mbulimi gjatë muajit Korrik 2024.

Obligacioni 3 vjeçar ka rezultuar me rendiment 4.15 % nga 4.19% me një rënie prej 0.04 % krahasuar me ankandin e muajit Korrik 2024.

Obligacioni 5 vjeçar ka rezultuar me rendiment 4.84 % nga 4.92 % me një rënie prej 0.08% krahasuar me ankandin e muajit Korrik 2024.

Obligacioni 15 vjeçar ka rezultuar me rendiment 6.98 % nga 7.45 % me një rënie prej 0.47% krahasuar me ankandin e muajit Maj 2024.

Për obligacionet me afat 2, 7 dhe 15 vjeçar nuk është zhvilluar ankand në muajin Gusht 2024, ndaj i referohemi interesave të emetimeve të fundit respektivisht 3.89%, 5.36% si dhe 6.13%.

Informacion Praktik

Trajtimi Fiskal

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, ose taksës mbi vlerën e shtuar. Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët bazohet në nenet 156, 157 dhe 158 të ligjit nr.76/2023, "Për Fondet e Pensionit Privat". Lidhur me detajet referojuni seksionit "Tatimi" të Prospektit të Fondit.

Deklaratë

Ky dokument ofron informacione kryesore për anëtarët në lidhje me Fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL. Anëtarët këshillohen dhe janë të ftuar të lexojnë Prospektin e Fondit në mënyrë që të marrin një vendim të mirë informuar. Informacioni i përditësuar mbi çmimin e kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur **SIGAL** dhe në <https://fondisigal.com.al/>

Kontakt:

Rr. "Ukraina e Lirë", Tiranë

Email: info@fondisigal.com.al

Tel: +355 (0) 44 511 666